Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 16 Dhjetor 2010

Nr. i rastit. 36/08

Jahja MORINA

kundër

UNMIK -ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm, më datë 16 dhjetor:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
Z. Rajesh TALWAR, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartshënuar, paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 marsit 2006, për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pasi diskutimeve vendos me sa vijon:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 11 gusht 2008 dhe është regjistruar më 20 gusht 2008. Parashtruesi i ankesës ofroi informata plotësuese më 6 tetor 2008.

2. Më 22 tetor 2008, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut për pranueshmërinë dhe natyrën e çështjes. Më 28 nëntor 2008, PSSP-ja u përgjigj, duke treguar se ankesa nuk ishte vërtetuar.

3. Më 15 dhjetor 2008, Paneli ia ri-komunikoi rastin PSSP-së për komentet e UNMIK-ut për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rastit, duke bashkëngjitur të dhëna shtesë të ofruara nga ankuesi.

4. Më datë 28 dhjetor 2008, Paneli mësoi për vdekjen e z.Jahja Morina më 19 nëntor 2008 dhe pranoi trashëgimtarët e tij, zotërinjtë Menditon dhe Besnik Morina, si persona të cilët kishin të drejtë që të ndjekin ankesën. Për arsye praktike, Paneli do të vazhdojë të quajë z. Jahja Morina si ankuesi, edhe pse ajo cilësi tani duhet t'u atribuohet zotërinjve Menditon dhe Besnik Morina.

5. Më 19 janar 2009, UNMIK-u dha përgjigje.

6. Më 23 prill 2009, Paneli kërkoi që UNMIK-u të sqarojë disa elemente të përgjigjes së tij. Më 2 korrik 2009, PSSP-ja ofroi komente të mëtejshme mbi rastin.

7. Më 9 shtator 2009, Paneli dërgoi komentet e PSSP-së parashtruesit të ankesës.

8. Ankuesi reagoi ndaj komenteve të PSSP-së në një letër te datës 25 shtator 2009 dhe ankuesi ofroi të dhëna shtesë në një letër të datës 22 tetor 2009.

9. Më 8 dhjetor 2009 dhe 26 shkurt 2010, Paneli i përcolli PSSP-së për informacion, reagimin e ankuesit dhe të dhënat shtesë.

II. FAKTET

10. Parashtruesi i ankesës, tani i vdekur, ishte pronar i kompanisë private "Top Gun", që gjendet në Gjilan, ku ai banonte. Biznesi i tij filloi së punuari pas pagesës së taksës administrative të kërkuar më 2 maj 2001 dhe i ishte lëshuar një numër i regjistrimit të biznesit të përkohshëm më 12 gusht 2001.

11. Më 4 tetor 2001, Zëvendës-administratori komunal i UNMIK-ut i Komunës së Gjilanit, i dërgoi një certifikatë KFOR-it, UNMIK-ut dhe Shërbimit Doganor ku shkruante se ankuesi ka qenë pronar i "Top Gun", dhe se biznesi është regjistruar. Certifikata deklaroi:

> "Është konfirmuar se biznesi është i miratuar dhe i autorizuar për t'u marrë me furnizimin e pajisjeve për aktivitetet sportive dhe te gjuetisë. Rrjedhimisht është e lejuar për të blerë dhe shitur artikuj të tillë gjuetie si plumba, harqe, shigjeta, kurthe, thika, mallra te peshkimit, dhe kushtet tjera të lidhura me gjueti dhe qitje.
>
> Aktivitetet e biznesit do të kërkojnë që ai të importon artikujt e duhur të pajisjeve. "

12. Më 16 tetor 2001, parashtruesi i ankesës paraqiti një amendament për regjistrimin e biznesit të tij për të ndryshuar strukturën e kompanisë dhe të riemërtoje atë "Sh.PT Top Gun ". Atij i ishte lëshuar një certifikatë e re e regjistrimit më 18 dhjetor 2001.

13. Më 21 korrik 2002, Administratori komunal i UNMIK-ut i komunës së Gjilanit i dërgoi një certifikatë shtesë KFOR-it, UNMIK-ut dhe Shërbimit Doganor për të konfirmuar të dhënat e mësipërme, duke shtuar se i është dhënë licenca për "një periudhë të pakufizuar derisa zotëria do të menaxhojë biznesin e tij. "

14. Ankuesi pohon se që nga koha kur ka filluar aktivitetet komerciale, ai është mbështetur në certifikatat e lëshuara nga Administratori komunal i UNMIK-ut i komunës së Gjilanit dhe ka njoftuar Policinë e UNMIK-ut (zyrat qendrore) dhe Policinë e UNMIK-ut në Gjilan, për pagesat e taksës doganore për municionet e importuara nga Shqipëria, Italia dhe Serbia.

15. Me kërkesën e një prokurori ndërkombëtar të UNMIK-ut, më 24 tetor 2002, një gjyqtar ndërkombëtar i UNMIK-ut lëshoi një urdhër kërkimi në shtëpinë e ankuesit, për armë, municione, dhe substanca të ndezshme në biznes, dhe automjete, dhe objekte në afërsi të pronave cituar në urdhër. Urdhri po ashtu shënonte edhe konfiskimin e dokumenteve të caktuara, disqe kompjuteri, etj, që mbulon periudhën prej 4 tetor 2001 deri në datën e kërkimit.

16. Më 29 tetor 2002, Policia e UNMIK-ut kreu një kërkim në lokalet përkatëse në prani të ankuesit dhe paraqiti një kopje të urdhër kërkimit të datës 24 tetor 2002. Gjithashtu, gjatë kontrollit Policia e UNMIK-ut i ofroi parashtruesit të ankesës një letër, të nënshkruar nga administratori komunal i UNMIK-ut i komunës së Gjilanit të datës 25 tetor 2002, duke deklaruar se Administratori komunal i UNMIK-ut "nuk kishte të drejtë që të lëshojë një autorizim të tillë te licencës" ose të drejtën për të shitur municion apo pajisje gjuetie dhe se parashtruesi i ankesës "duhet të konsiderojë këtë leje si të pavlefshme."

17. Policia e UNMIK-ut konfiskoi të gjitha dokumentet e municionit dhe biznesit që ai mbante në dyqanin e tij dhe i ofroi atij një listë të gjërave të konfiskuara, duke konfirmuar se më tepër se 50.000 copë municion, si dhe një numër të dokumenteve dhe shënimeve të biznesit u konfiskuan. Sipas ankuesit, ata gjithashtu gjetën një pushkë të tij të gjuetisë, por pasi që ai kishte një autorizim i vlefshëm të UNMIK-ut për armëmbajtje, ata nuk e konfiskuan atë. Policia e UNMIK-ut mori në pyetje ankuesin dhe kërkoi që ai të ndërpriste çdo urdhër të mëtejshëm për municion dhe të informojë policinë për arritjen e ndonjë dërgese në pritje.

18. Më 31 tetor 2002, parashtruesi i ankesës nënshkroi urdhra për dyqanet e tij jashtë Gjilanit që të ndalojnë shitjen e municioneve. Më 1 nëntor 2002, ankuesi i dërgoi një letër Policisë së UNMIK-ut duke kërkuar autorizim për të shitur municion.

19. Më 5 nëntor 2002, ankuesi u takua me Policinë e UNMIK-ut dhe tregoi se një ngarkesë e municioneve e urdhëruar para kontrollit të lokaleve të tij do të mbërrijë në Kosovë më 6 nëntor 2002. Kur dërgesa e 182.250 fishekëve arriti më 7 nëntor 2002, një ditë me vonesë, Policia e UNMIK-ut konfiskoi municionin dhe lëshoi një listë të gjërave të konfiskuara

20. Pas kontrollit të dyqanit të tij në Gjilan, ankuesi kërkoi që dyqanet tjera në Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe Rahovec të ndalojnë shitjen e municionit dhe kthimin e të gjithë aksioneve të mbetura në dyqanin e Gjilanit. Më 12 nëntor 2002, Policia e UNMIK-ut konfiskoi 4.072 fishekë që iu ishin kthyer në dyqanin e Gjilanit dhe përsëri i ofruan parashtruesit të ankesës një listë të gjërave të konfiskuara.

21. Më 28 dhjetor 2002, një gjykatës hetues ndërkombëtar i UNMIK-ut lëshoi një tjetër urdhër kërkimi për shtëpinë e ankuesit dhe automjetet, por nuk është e qartë nëse ndonjë gjë është konfiskuar gjatë kryerjes së këtij urdhri.

22. Nuk ka asnjë tregues se pas urdhër kërkimit të dytë ndonjë aktivitet tjetër hetimor u zhvillua në lidhje me veprimtarinë e supozuar kriminale të ankuesit.

23. Më 10 prill 2003, avokatët e ankuesit i shkruan kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke kërkuar kthimin e mallit të konfiskuar. Në këtë letër, ata deklaruan se Prokurori

Publik Ndërkombëtar i tha ankuesit se ajo nuk e ka në plan të fillojë ndonjë procedurë penale kundër ankuesit pasi nuk kishte arsye për të bërë kështu. Ata pohuan se, sipas nenit 209 të Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr 26/86), në fuqi në atë kohë, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr 1999/24 mbi Ligjin e aplikueshëm në Kosovë të 12 dhjetorit 1999, kërkohet që pasuria e konfiskuar duhet të kthehet menjëherë pasi që prokurori nuk kishte gjetur ndonjë dëshmi për shkelje penale.

24. Gjithashtu, më 10 prill 2003, avokatët e ankuesit i shkruan Prokurorit ndërkombëtar të UNMIK-ut i cili kishte kërkuar urdhër kërkimin dhe kërkuan që municioni t'i kthehet ankuesit, duke vënë në dukje se ai do të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të UNMIK-ut nr i Urdhëresës Administrative 2003/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/7 mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, të datës 17 janar 2003, lidhur me depononim e municionit të tillë. Në këtë letër, avokatët e ankuesit gjithashtu iu referuan bisedës në mes përfaqësuesve të ankuesit dhe Prokurorit ndërkombëtar të UNMIK-ut lidhur me mungesën e bazës ligjore për ndjekje penale të ankuesit. Në letër theksohet se shkatërrimi i municionit do t'i shkaktojë ankuesit dëme të papranueshme. Avokatët e ankuesit gjithashtu i dërguan një letër në të njëjtën datë gjyqtarit ndërkombëtar të UNMIK-ut i cili kishte urdhëruar kërkimin, duke përsëritur deklaratat e mësipërme.

25. Më 6 qershor 2003, ankuesi i shkroi Policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës, duke u sqaruar në hollësi ngjarjet e mësipërme, dhe duke kërkuar leje për të shitur municion në pajtim me mirëkuptimin e tyre të Urdhëresës Administrative nr 2003/1 të UNMIK-ut, dhe duke vënë në dukje se gjatë një bisede të mëparshme të datës 26 mars 2003 me Prokurorin Publik Ndërkombëtar të UNMIK-ut, i ngarkuar me hetimin penal, ankuesi mësoi se municioni përfundimisht do të shkatërrohet.

26. Më 20 qershor 2003, Policia e UNMIK-ut në Gjilan iu përgjigj ankuesit duke thënë se "Rregullorja për legalizimin e dyqaneve për shitjen e municioneve dhe pajisjeve të tjera të gjuetisë është në proces".

27. Më 24 prill 2004, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë i shkroi zëvendësit të PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke kërkuar nga ai që të tregojë dispozitat e mbështetura ligjore të UNMIK-ut që refuzojnë të drejtën e ankuesit për të kryer tregtinë e tij. Në një letër të 16 dhjetor 2004, zëvendësi kryesor i PSSP-se u përgjigj se:

> "pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi të armëve në Kosovë për çfarëdo qëllimi, duke përfshirë tregtinë, janë subjekt i kërkesave të rrepta dhe kufizimeve të paraqitura nga UNMIK-u në legjislacionin e tij në pajtim me mandatin e tij.
>
> Kjo është në thelb një çështje e sigurisë dhe duhet të trajtohet në përputhje me rrethanat.
>
> Në pritje të zhvillimit të vazhdueshëm dhe finalizimin e një kornize gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon gjuetinë, dhe nënshtrimin e një vendimi autoritativ për vendosjen e kushteve të nevojshme të sigurisë, aktivitetet e gjuetisë në Kosovë janë te pezulluara.
>
> Nëse dhe kur të gjitha kërkesat për aktivitetet e gjuetisë te lejuara në Kosovë janë plotësuar dhe kur situata e sigurisë lejon, një Rregullore e UNMIK- ut mund të përdoret për të bërë tregti dhe import të armëve të gjuetisë, duke përfshirë edhe municion dhe pajisje "(theksuar në origjinal).

28. Më 10 shkurt 2004, një organizatë jo-qeveritare e quajtur Qendra për Mbrojtjen e Resurseve Kriminale (QMRK) i shkroi Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore duke kërkuar se çfarë hapash duhet të marrin për të zgjidhur situatën, duke vënë në dukje se Rregullorja e UNMIK-ut nr 2000/47 e 18 gushtit 2000 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, nuk lejon ndonjë mjet juridik që parashtruesi i ankesës mund të ketë pasur kundër UNMIK-ut.

29. Më 18 qershor 2008, ankuesi i shkroi kryetarit të gjykatave të qarkut në Gjilan dhe Prishtinë si dhe prokurorëve publikë ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe Prokurorit Publik të Kosovës në Gjilan dhe Prishtinë, duke përmbledhur faktet e rastit të tij dhe për të kërkuar konfirmim se a ka ndonjë procedurë ligjore në pritje kundër tij në gjykatat përkatëse ose prokurorive. Kryetari i gjykatës së qarkut të Gjilanit dhe Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut të Gjilanit u përgjigjen se ata nuk kishin ndonjë lëndë për rastin e ankuesit në zyrat e tyre. Prokurori Publik i Qarkut deklaroi se letra në adresë të Prokurorit Publik Ndërkombëtar të UNMIK-ut ishte dërguar në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut në Prishtinë.

30. Më 12 shtator 2008, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës i dërgoi një letër ankuesit, bashkëngjitur vendimin e 8 gushtit 2008 të Prokurorit Special të cilat i hedhin poshtë akuzat penale të parashtruar kundër ankuesit. Nga vendimi i Prokurorit Special duket se rreth 1.070 copë municione të tjera i janë konfiskuar ankuesit më 22 janar 2003 dhe 27 janar 2003. Prokurori special konkludon se "në kohën që ai ushtroi biznesin e tij ai kishte një licencë të vlefshme dhe veprimtaria e tij nuk mund të konsiderohet si e paligjshme".

31. Më 22 shtator 2008, ankuesi dërgoi një ankesë kundër aktvendimit të Zyrës se Prokurorit Special duke kërkuar një shpjegim se pse rasti ishte në zyrën e prokurorit për gjashtë vjet para se të shqyrtohet, duke pretenduar se një numër i shkeljeve të kodit të procedurës penale kishte ndodhur gjatë procedurës kundër tij, dhe duke kërkuar që dokumentet dhe municioni i konfiskuar t'i kthehet atij. Ai gjithashtu kërkoi sqarime të detajuara në lidhje me bazën ligjore për shkatërrimin e municioneve të përfolura që ishin dërguar në selinë e kontingjentit në kampin "Bondsteel" të KFOR-it të Shteteve te Bashkuara në rajonin e Gjilanit.

32. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me Sundimin e Ligjit te Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX) duke marrë përsipër kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Presidenti i Këshillit te Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

33. Më 9 shkurt 2009, përfaqësuesi i trashëgimtarëve të ankuesit i shkroi Prokurorisë Ndërkombëtare të EULEX-it, përgjegjës për vazhdimësisë e Zyrës se Prokurorit Special të Kosovës, duke kërkuar një vendim mbi çështjet e përmendura në kërkesën e ankuesit të datës 22 shtator 2008. Prokurori Ndërkombëtar i EULEX-it iu përgjigj ankuesit duke thënë se EULEX-i nuk është përgjegjës për të shkatërruar artikujt e konfiskuar nga UNMIK-u dhe se kompensimi duhet të kërkohet nga autoritetet përkatëse.

34. Përfaqësuesi i trashëgimtarëve u përgjigj duke i dërguar një letër të mëtejshme Kryeprokurorit ndërkombëtar të EULEX-it më 25 korrik 2009, duke thënë se meqenëse ai ishte në dijeni të përgjegjësive të EULEX-it, Zyra e Prokurorit Special që vepron në EULEX duhet të ketë të gjitha dokumentet që mbanin më parë nga zyra kur ishte nën UNMIK-un, dhe për këtë arsye ata duhet të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesës së 22 shtatorit 2008.

35. Kryeprokurori ndërkombëtar i EULEX-it u përgjigj më shtator 2009, duke thënë se si rasti i ankuesit u konsiderua i mbyllur në kohën e dorëzimit të përgjegjësisë, dhe se EULEX-i nuk posedonte ndonjë dëshmi të mbajtur nga UNMIK-u, e cili duhet të ketë qenë trajtuar para dorëzimit te përgjegjësive. Ai vazhdoi të pohonte se EULEX-i është në gjendje për të gjetur një dosje "në ndërtesat e UNMIK-ut", e cila përmban listën e gjërave të sekuestruara dhe librat financiar, por se ata nuk kishin të regjistruar se çka ndodhur më pas me artikuj të tillë pas vitit 2002. Ai gjithashtu tha se EULEX-i nuk mund të gjejë ndonjë të dhënë në lidhje me shkatërrimin e gjërave nga KFOR-i dhe se duhet kërkuar drejtpërdrejtë nga KFOR-it për të marrë të dhëna e tilla.

36. Përfaqësuesi i trashëgimtarëve i tregoi Panelit më 25 shtator 2009, që në ndërkohë, ata kishin kontaktuar me kontingjentin e KFOR-it të Shteteve te Bashkuara në lidhje me urdhrin për të shkatërruar ndonjë dëshmi në rastin e ankuesit. KFOR-i i Shteteve te Bashkuara i tha ankuesit që të kontaktojnë drejtpërdrejt institucionin e përfshirë, përkatësisht UNMIK-un.

37. Si një shtojcë për dorëzimin e 25 shtatorit 2009, përfaqësuesi i trashëgimtarëve i bashkëngjiti dy deklarata të nënshkruara nga shoqata e gjuetisë së Kosovës që tregojnë se, që prej shtatorit 2009, nuk kishte asnjë mënyrë me anë ligjore për të marrë municion për gjueti ose sport në Kosovë. E vetmja mënyrë për të marrë municion e tillë ishte përmes tregut të zi.

III. ANKESA

38. Parashtruesi i ankesës në mënyrë specifike ankohet se UNMIK-u ka shkelur të drejtën për gëzimin e të drejtave të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), pavarësisht nga statusi ndërkombëtar i territorit në të cilin një person banon (neni 2 i DUDNJ), të drejtën e lirisë nga diskriminimi dhe mbrojtje të barabartë para ligjit (neni 7 i DUDNJ), të drejtën për një ankimim efektiv përpara një gjykate kombëtare (neni 8 i DUDNJ), dhe të drejtën të jenë të lirë nga heqja arbitrare e pronës (neni 17 i DUDNJ).

39. Përveç kësaj, ankuesi sjellë prova se UNMIK-u është përgjegjës për një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm dhe të drejtën e qasjes në gjykatë, të garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), e drejta për një mjet efektiv të garantuar me nenin 13 të KEDNj-së dhe të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi në gëzimin e të drejtave të garantuara me nenin 14 të KEDNJ.

IV. LIGJI

40. Para se të trajtojë bazueshmërinë e çështjes, së pari Paneli duhet të vendosë nëse do të pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të UNMIK-ut nr 2006/12.

41. Në komentet e para të datës 28 nëntor 2008, PSSP-ja pohoi se rasti ishte i papranueshëm ne shikim të parë, pasi që ankuesi nuk arriti të sigurojë të gjitha faktet relevante mbi të cilat supozohet të ketë ndodhur shkelja e të drejtave të njeriut siç kërkohet nga neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2006 / 12.

42. Në paraqitjen e tij të dytë mbi pranueshmërinë, PSSP-ja pohon se në shikim të parë ankesa është e papranueshme meqenëse ankuesi nuk kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion. PSSP-ja në mënyrë eksplicite thotë:

> "Nga dokumentacioni i paraqitur, kuptohet se mund të kenë ndodhur gabime administrative në nivel të administratës komunale. Një ankesë administrative duhet t'i bëhet Komunës së Gjilanit në lidhje me kërkesën për kompensim të pronës së konfiskuar duke marre parasysh vendimin e Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës të datës 8 gusht 2008. Në këtë drejtim, kjo do t'i ndihmojë ankesës, në qoftë se Zyra e Prokurorit Special të Kosovës në Prishtinë do të lëshojë një vendim të mëtejshëm ose të japin informacione të mëtejshme mbi pronën e konfiskuar. Një kërkesë për të apeluar kundër procesit gjyqësor mund të bëhet në Gjykatën e Qarkut ose Gjykatën Supreme. "

43. Në sqarimin e tij të mëtejshëm të datës 3 korrik 2009, PSSP-ja pohoi me sa vijon:

> "Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, kuptohet se më 8 gusht 2008, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (të ZPSK) lëshoi një vendim ku të gjitha akuzat penale kundër z. Morinës u hodhën poshtë. Në përgjigje të këtij vendimi, z. Morina ka kërkuar nga ZPSK që prona e tij dhe të dhënat e biznesit të kthehen tek ai. Me sa duket z. Morina nuk ka marrë ende një përgjigje për këtë kërkesë. Duke pasur parasysh se kjo kërkesë është në pritje, parashtruesi i ankesës duhet të presë rezultatet e kësaj përgjigje të cilat duhet të sqarojnë dëmshpërblimin që ai kërkon. Varësisht nga rekomandimi i Prokurorit Special, mund të ndodhë qe familja e z. Morinës, e cila përfaqëson z. Morinën pas vdekjes së tij më 19 nëntor 2008, do të duhet t'i drejtohet komunës Gjilanit dhe KFOR-it përmes procedurave përkatëse administrative, në mënyrë që të marrin kompensimin që ata kërkojnë. "

44. Në fillim, Paneli kundërshton pohimin se ankesa nuk ishte e arsyetuar në kuptim të nenit 11.1 të Rregullores nr. 2006/12 të UNMIK-ut. Paneli vëren se në ankesën e tij fillestare, parashtruesi i ankesës i ka dhënë të gjitha faktet e nevojshme për përcaktimin e tij.

45. Lidhur me kundërshtimin e PSSP-së për mos-shfrytëzimin e mjeteve, Paneli vëren se mjetet e sugjeruara nga PSSP-ja nuk duket të ketë ndonjë bazë ligjore, ose të paktën nuk ka bazë që UNMIK-u është në gjendje të identifikojë. Procedurat administrative të identifikuara, edhe nëse ato ekzistonin, nuk merren me çështjen e ankesës, d.m.th, një ndjekje kriminale e paligjshme për të konfiskuar mallra nga ankuesi. Edhe pse Administratori komunal i UNMIK-ut i Komunës së Gjilanit mund të ketë vepruar përtej përgjegjësive në dhënien e së drejtës ankuesit për të shitur municion, akti i shfuqizimit të licencës së tij për të shitur municion nuk thuhet të ketë privuar ankuesin nga pasuria e tij, e as nuk e ka nënshtruar atë ndaj një hetimi të zgjatur penal.

46. Aq sa PSSP-ja konsideron se mjetet e përshkruara më lart ofrojnë një mjet civil për marrjen e pronës së ankuesit, Paneli vëren se ankuesi pohon se nuk ekziston mjet i tillë në ligj. Meqenëse PSSP-ja nuk ka qenë në gjendje të identifikojnë bazën ligjore për mjetet e tilla të pohuara, Paneli konsideron se duhet të shqyrtohet bazueshmëria e kësaj çështje. Edhe pse PSSP-ja ngre këto çështje gjatë seancave te fazës së pranueshmërisë, Paneli kujton se kur çështja e pranueshmërisë është e lidhur ngushtë me bazueshmërinë e ankesës, Paneli, në bazë të Rregullit 31 - rishikimi i dyte- të Rregullores së Punës së Panelit, mund të bashkojë çështjen me bazueshmërinë, me kusht që të mos ketë asnjë pengesë tjetër për pranueshmërinë (shih Panelin Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut, PP, nos. 120/09 dhe 121/09, vendimin e datës 26 nëntor 2010).

47. Nuk është konstatuar asnjë arsye tjetër për ta shpallur ankesën të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

SHPALL ANKESËN TE PRANUESHME

Rajesh TALWAR
Zyrtar Ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar